



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

T.+355-4-2281695 E. juridical@cec.org.al,
www.cec.org.al



DREJTORIA JURIDIKE

RELACION

PËR MIRATIMIN E FLETËS TIP SIPAS KËRKESËS SË KOMITETIN PËRFAQËSUES, PËR NISMËN LIGJVËNËSE TË ZGJEDHËSVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT KOMBËTAR TË AUTORËVE TË KRIMEVE SEKSUALE"

Në datë 09.06.2020, Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse znj. Iris Luarasi përfaqësuese e Qendrës "Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, znj. Ines Leskaj përfaqësuese e shoqatës "Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri" dhe znj. Mirela Arqimandriti përfaqësuese e Qendrës "Aleanca Gjinore për Zhvillim kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesat nr.1149 prot., datë 09.06.2020 dhe nr.1149 prot., datë 18.06.2020 për pajisje me fletë tip për mbledhjen e nënshkrimeve. Bashkëlidhur kërkesës komiteti përfaqësues ka depozituar edhe kopje të kartave të identitetit.

Këto organizata në bashkëpunim me njëra tjetrën kërkojnë të ndërmarrin nismën ligjore, duke i propozuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë këtë projektligj "Për krijimin e Regjistrit Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale".

Projektligji që do ti propozohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, lidhet me mbrojtjen e viktimave nga abuzimi seksual.

Për realizimin e kësaj nisme ligjore është krijuar Komiteti Përfaqësues i nismës ku secila organizatë ka caktuar një përfaqësues, përkatësisht Qendra "Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza" ka caktuar si përfaqësuese Drejtoren, znj. Iris Luarasi, Shoqata Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri" ka caktuar si përfaqësuese Drejtoren znj. Ines Leskaj, dhe Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim ka caktuar si Përfaqësues znj. Mirela Arqimandriti.

Ky komitet, përfaqësues i nismës do të merret me gjithë procesin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve. Projektligji që do ti propozohet Kuvendit të Shqipërisë, është projektligji "Për Krijimin Regjistrin Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale". **Me anë të këtij projektligji propozohet krijimi i një regjistri kombëtar të autorëve të krimeve seksuale, regjistër i cili do të jetë publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë.**

Kërkesën e tyre përfaqësuesit e nismës ligjvënëse e bëjnë në mbështetje të nenit 6, pika 4, neni 10 pika 1 e ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë".



Në mbështetje të nenit 10 pika 2 të ligjit nr.54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë", KQZ, duhet të pajis përfaqësuesit e nismës me fletën-tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme. Referuar nenit 10 të ligjit të sipërcituar, fleta-tip e mbledhjes së nënshkrimeve, në njëërën duhet të përmbajë informacionin mbi nismën ligjvënëse që do ti propozohet Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj si dhe të dhëna për përfaqësinë / komitetin përfaqësues të nismës ndërsa në anën tjetër duhet të përmbajë; numrin rendor, gjenealitetet e zgjedhësit që mbështet nismën, vendin e datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit apo pasaportës së zgjedhësit, kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve si dhe hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve.

Kërkesa e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse përmban, informacionin mbi nismën ligjvënëse që do ti propozohet Kuvendit, qëllimin dhe shpjegimin në mënyrë të përmbledhur të saj si dhe të dhënat e komitetit përfaqësues të nismës.

Dëshira PASKO – Drejtoria Juridike

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së

